

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Rasim Rasimi kryetar i kolegjit, Gani Zabeli dhe Shqipe Qerimi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.K. nga ..., Komuna ... për shkak të veprës penale shmangie nga tatimi, nga neni 249 par.2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, P.nr.58/2012, datë 01.04.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 08.08.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, P.nr.58/2012, datë 01.04.2016, **Vërtetohet.**

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, me aktgjykimin P.nr.58/2012, datë 01.04.2016 të akuzuarin E.K. konform nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KPPK-së, e ka liruar nga akuza për veprën penale shmangie nga tatimi, nga neni 249 par.2 të KPK-së, me arsyetim se nuk është provuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Shpenzimet e procedurës penale i janë ngarkuar mjeteve buxhetore të gjykatës. E dëmtuara ATK-ja në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka ushtruar Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan vetëm për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Prokurori i Apelit në Prishtinë me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.714/2016, datë 07.06.2016, ka propozuar që ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan të aprovohet si

e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekura ne ankesë, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, më gjithat Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës se nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Sa i përket bazës ankimore vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, me ankesë Prokurori pretendon se gjykata e shkallës së parë në shqyrtimin gjyqësorë nuk i ka shtjelluar provat në mënyrë të drejtë dhe të plotë, duke konstatuar se nuk ka pasur prova me të cilat do ta vërtetonin faktin se i akuzuari E.K. ka kryer veprën penale shmangie nga tatimi nga neni 249 par. 2 të KPK-së. Përkundër dëshmime të dëshmitarëve I.K. dhe Selami Zjenullahu, ekspertiza financiare, si dhe provat tjera materiale, gjykata aktgjykimin e ka bazuar vetëm në pranimin e të akuzuarit i cili shmangien nga obligimi i taksave të detyrueshme ligjore e arsyeton në pamundësinë financiare për pagesë, ku të njëjtin e liron nga përgjegjësia penale, pa bazë ligjore.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit pretendimet e mësipërme me ankesë janë të pabazuara, nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimit të ankimuar rezulton se i akuzuari E. është akuzuar për veprën penale shmangie nga tatimi nga neni 249 par. 2 të KPK-së, sepse “nga data 01.08.2008 deri me datën 30.06.2009 në cilësinë e pronarit të N.T.B. “NN” me seli në ..., K. ..., duke zhvilluar veprimtarin e kontrollit teknik të automjeteve ka kryer veprën penale shmangie nga tatimi, në atë mënyrë që gjatë kontrollimit që është bërë nga ana e inspektorëve tatimor është konstatuar se në vitin 2008 i pandehuri në cilësinë e punëtorit përgjegjës, nuk ka deklaruar dhe nuk ka paguar tatime, ashtu me qëllim i është shmangur pagesës së tatimeve dhe kontributeve për zhvillimin e aktivitetit të tij afarist në shuma të ndryshme..., ku ka dëmtuar buxhetin e R. të Kosovës në shumë të përgjithshme prej 35,528.87 €”.

Meqë, i akuzuari nuk e ka pranuar akuzën, gjykata ka administruar provat e propozuara me dëgjimin e dëshmitarit S.Z., I.K., ka vlerësuar ekspertizën financiare të ekspertit financiar gjyqësorë R.B., raportin e kontrollit të datës 15.10.2011, gjendjen nga SIGITAS-i të datës 26.10.2009, njoftimin – rivlerësimin për TAI, KTBVI, KP, TMB, letër kujtesën për pagesë e datës 27.10.2009, njoftimin – vlerësimet pas kontrollës të datës 23.10.2009, vërejtja e fundit për pagesë të tatimit, si dhe shkresat tjera të lëndës, ku gjykata ka konkluduar se nuk është dëshmuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, konkludim këtë të cilin e mbështet edhe kjo gjykatë.

Dëshmitari I.K. – inspektor i ATK-së, në dëshminë e tij të deponuar në gjykatë, ka pohuar se i akuzuari E.K. , duke qenë në cilësinë e personit përgjegjës në biznesin e tij, ka deklaruar se tatimet të cilat ka pasur për obligim t'i deklaroj, si tatimin e vlerës së shtuar (TVSH), tatimi vjetor i pasqyrave të ardhurave brenda vitit, për çdo vit dhe se nuk ka mundur t'i ik tatimit për shkak se ka qenë i obliguar që për çdo kontroll teknike të automjetit të lëshoj dokument, se në rastin konkret nuk ka fshehje nga tatimi, pasi që numri i kontrolleve teknike që i ka prezantuar i akuzuari përputhet me numrin e kontrolleve të cilat i ka poseduar Ministria e Transportit. Sipas dëshmitarit i cili është edhe inspektor i ATK-së, mos pagesa e detyrimit tatimor me kohë nuk paraqet shmangie nga detyrimi tatimor. Eksperti financiar – gjyqësorë R.B. në ekspertizën e tij të datës 30.12.2015 në konstatimin dhe mendimin e dhënë thekson se E.K. në cilësinë e pronarit të biznesit individual “Kosova Komerc”, për periudhën 01.01.2008 deri me 30.06.2009 ka bërë deklarin e detyrimeve tatimore dhe kontributeve, por nuk ka bërë shlyerjen e të njëjtave dhe atë: për periudhën 01.01-31.12.2008 në shumë prej 22,901.33 € dhe për periudhën 01.01.-30.06.2009 në shumën prej 11,164.98 €, e gjithsej detyrimet e deklaruara por ta papaguara kapin shumën prej 34,066.31 €.

Nga provat e administruara gjykata ka konstatuar se i akuzuari ka përmbushur detyrimin e tij ndaj ATK-së, në momentin e paraqitjes së shënimeve lidhur me të ardhurat ligjore, sendet dhe faktet tjera të cilat ndikojnë në lartësinë e tatimit, vepra penale për të cilën akuzohet i akuzuari konsiderohet e kryer me mos paraqitjen ose paraqitjen e pavërtetë të këtyre tatimeve, kjo veprë penale kryhet me dashje direkte, me qëllim të shmangies të tërësishme apo të pjesërishtme të tatimit, tarifave apo kontributeve tjera të përcaktuara me ligj, pra kjo veprë konsumohet vetëm kur kryerësi është i vetëdijshëm për dhënien e shënimeve të pavërteta lidhur me faktet relevante për t'iu shmangur tatimit, tarifave dhe kontributeve tjera, por jo edhe kur të gjitha janë të lajmëruara me kohë dhe në mënyrë të rregullt, e vetëm për shkak të pamundësisë së shlyerjes së detyrimeve nuk ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, inkasimi i tatimeve në këto raste bëhet në procedurën administrative nga organi kompetent në mënyrë të dhunshme.

Të gjitha këto rrethana nuk japin bazë të mjaftueshme që i akuzuari të shpallet fajtorë, sepse në shkresat e lëndës nuk ka asnjë provë e cila do ta vërtetonte një gjë të tillë, e këtë nuk e pohon as dëshmitari – inspektori i ATK-së, e as ekspertiza financiare – gjyqësore, ndërsa nga ana tjetër Prokurori në këtë drejtim nuk ka ofruar ndonjë provë konkrete, e cila në mënyrë të sigurt do ta vërtetonte fajësinë e të akuzuarit Enver, prandaj gjykata e shkallës së parë drejtë konkludon se nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Nga rrethanat e cekura më lartë dhe ato të theksuara në aktgjykimin e ankimuar, konkludimi i gjykatës së shkallës së parë për lirimin e të akuzuarit nga përgjegjësia penale është i bazuar dhe i ligjshëm, e të cilin konkludim e mbështet edhe nga kjo gjykatë.

Nga sa u tha më lartë e sipas dispozitës së nenit 401 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.671/2016, datë 08.08.2016

Bashkëpunëtor profesional,
Hysni Ismaili,

Kryetar i kolegjit
Rasim Rasimi

Anëtarët e kolegjit:

Gani Zabeli
Shqipe Qerimi